URDHËR
Nr.193, datë 20.3.2020

PËR MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të pikëS 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4, dhe 15, të ligjit nr.15/201,"Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Lejohen të kryejnë aktivitetin e tyre vetëm në fashën orare 05:00 – 13:00, duke filluar nga dita e hënë, datë 23.3.2020, pikat e shitjes së produkteve ushqimore, me pakicë dhe shumicë, pikat e tregtisë së barnave, produkteve mjekësore dhe institucionet fnanciare.
2. Kufizimin e lëvizjes, në gjitha qendrat urbane të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha kategoritë (këmbësor, biçikleta, ciklomotor, motomjete dhe mjete) duke filluar nga ora 13:00 e ditës së shtunë, datë 21.3.2020 deri në orën 05:00, të datës 23.3.2020. Përjashtohen nga ky rregull të gjitha mjetet e transportit të mallrave dhe të produkteve ushqimore, Policia e Shtetit, Forcat e Armatosura, njësitë kritike të shërbimeve shtetërore dhe atyre të kompanive mediatike si dhe shërbimet në banesë (delivery).
3. Ndalohet ofrimi i shërbimit ndaj qytetarëve nga të gjitha aktivitet, përfshirë ato të përcaktuara në pikën 1 dhe në tabelën bashkëlidhur këtij urdhri, duke filluar nga ora 13:00 e ditës së shtunë, datë 21.3.2020, deri në orën 05:00, datë 23.3.2020. Lista me aktivitetet e përcaktuara në tabelën bashkëlidhur këtij urdhri hyn në fuqi në orën 05:00 të datës 24.3.2020.
4. Punonjësit e institucioneve financiare, të linjave prodhuese e ushqimore, dhe të gjitha aktivitetet e lejuara, sipas tabelës bashkëlidhur këtij urdhri, do të lejohen të qarkullojnë vetëm për itenerarin shtëpi–punë.
5. Çdo rregull i përcaktuar nga urdhrat e mëparshëm, që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu